

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Gusht 2009 Nr. 28. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

EVROPA RACISTE PERJASHTON NGA LIBERALIZIMI I VIZAVE TRE VENDE MUSLIMANE

Këshilli i Evropës sapo ka marrë një vendim absurd dhe racist për të lënë Shqipërinë Kosovën dhe Bosnjën jashtë liberalizimit të vizave, duke arsyetuar se nuk janë realizuar standartet, argumente keto fallso në një kohë që Shqipëria i ka plotësuar 90 % të standarteve. BE u ka ndezur driten jeshile vendeve të tilla si Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia të cilat, sipas Evropës raciste dhe te krishterë, i kanë realizuar standartet. Por BE nuk ka pasë si kriter standartet, por ka pasë problem popullsinë dominante muslimane që kane Shqipëria Kosova dhe Bosnja. Saktësisht tashmë po vertetohet se Evropa e krishterë po i përjashton muslimanët e Ballkanit nga familja evropiane, duke krijuar një geto politike që mund të marrë jo shumë vonë pamjen e një kampi përqëndrimi të rrëthuar me mure, pas të cileve sillen muslimanët e Ballkanit pa shpresë për të lëvizur pa viza në Evropën e Bashkuar. I vetmi standart që nuk plotësojnë këto tre shtete është përkatësia e tyre fetare e cila duket se i bën të flasin me vehte ata që i kane në dorë letrat dhe vulat për të dhënë lejkalimi për të lëvizur në Evropë pa viza. Tashmë BE është diskredituar me vendimin që ka marrë, sepse kriter bazë për liberalizimin e vizave ajo përcaktoi treguesin fetar dhe jo arritjen e standarteve të kërkuara për këto shtete. Po saktësohet përfundimisht idea se problemi që ka sot Evropa e krishterë nuk janë standartet, por është feja muslimane, duke shfaqur kështu një urrejtje për njerëzit që e mbartin këtë fe. Të mos harrojmë se Turqia vazhdon të jetë viktimë e këtij racizmi antimusliman të BE, sepse për liberalizimin e vizave për Turqinë as që u bë fjalë as kësaj rralle.



Askush nuk mund të vërë në dyshim dëshirën e BE për të antarësuar në rrallët e saj shtete që kanë përkatësi dominante të krishterë, sepse edhe vetë BE ka këtë frymë drejtuese. Standartet që gjoja nuk ka plotësuar Shqipëria janë një perde tymi për të mbuluar fëtyrën e vërtetë të BE që haptas propozoi tre vende me përkatësi fetare ortodokse që janë shumë larg standarteve që plotëson sot Shqipëria të cilat janë pohuar edhe nga faktori ndërkombëtar që për fat të keq, kur është fjala për t'u dhënë të drejta muslimanëve, përdor dy standarte duke ua mohuar të drejtat që u takojnë. Me vendimin që mori BE për të lënë shqiptarët muslimanë jashtë mureve të Evropës, u bë i johur fakti, që edhe dihej, se shqiptarët do të jenë të përbuzërit e Evropës gjithë jetën dhe se premtimet që do t'u hiqen vizat në 2010 nuk janë shumë bindëse. Lënia e vendeve muslimane jashtë

mureve të Evropës tregon se tashmë Evropa nuk po kërkon plotësim standartesh nga këto vende, por ndryshim të fesë muslimane. Është për të ardhur keq, kur shikon si nxitet racizmi kundër muslimanëve në emër të kulturës kristiane si kulturë gjoja e paqes dhe e civilizimit. Vetëm shqiptarët dhe muslimanët në Ballkan mbetën të diskriminuar në Evropë, sepse po bëhet një izolim i ri i muslimanëve të Ballkanit që ato të mos lëvizin pa viza nëpër Evropë, por të sillen nëpër ambasada në shi, diell dhe deborë e akull, për të marrë një vizë të cilën sot e gëzojnë vende që janë larg standarteve teknike, por në një linjë me parametrat fetarë që rezonojnë me Evropën raciste dhe antimuslimane. Por, racizmi kundër shqiptarëve muslimanë dhe muslimanëve të tjerë në Ballkan është paralajmëruar në parathënien e Kuranit Famëlartë, ku dijetari egjiptian, Ahmed Raif,

paralajmëron që në vitin 1992 se muslimanët shqiptarë janë të kërcënuar se bashku me boshnjaket, dhe shqiptarët e Kosovës nga rreziku i konvertimit të tyre në të krishterë. Kuptohet se pjesë e këtyre përpjekjeve është edhe mohimi i të drejtës për të lëvizur pa viza i muslimanëve shqiptarë dhe i atyre boshnjakë në vendet e BE, ku tashmë do të lëvizin vrasësit e boshnjakëve dhe të kosovarëve, por për asnjë arsye nuk do të lëvizin viktimat e tyre, muslimanët, të cilët, Evropa, ky klub i krishterë, që dërgon ushtarë për të vrarë muslimanë në Afganistan dhe Irak, i ka dënuar të struken në një geto muslimane në Ballkan, ku lëvizja e lirë dhe pa viza nëpër Evropë do të vazhdojë të mbetet një ëndër e largët, persekutim dhe racizëm të cilin sot realisht e ndjen mbi kurriz Turqia me popullsi absolute muslimane.

Selim Gokaj

PERJASHTIMI I SHQIPERISE RACIZEM I BE NDAJ MUSLIMANEVE

Përjashtimi i Shqipërisë nga liberalizimi i vizave është një akt i pastër kanceroz dhe racist i BE ndaj shqiptarëve, sepse pengesë kryesore është përkatësia e tyre fetare. Të gjithë pretendimet evropiane ndaj Shqipërisë ishin pjesë e maskaradës ndaj një popullsie e cila jeton në mes të Evropës e rrethuar nga gardhi imagjinar i vendosur nga evropianet. Tashmë shqiptarët jetojnë të rrethuar në një kamp të madh izolimi nga shtete të cilat jetojnë të gjitha në një komunitet, ku vetëm shqiptarët nuk mund të kalojnë gardhin e përqendrimit. Vetëm harta e Shqipërisë nxin në të gjithë kontinentin evropian, ku shtetet fqinjë si: Maqedonia, Serbia, Mali i Zi kanë të drejtë të lëvizin lirshëm nëpër Evropë. Dje evropianët konfirmuan hapur se shqiptarët do të jenë gjithë jetën të përbuzurit e Evropës dhe se

premtimet për t'u dhënë viza në vitin 2010 janë një mashtrim i rrallës. Përjashtimi i Shqipërisë nga harta e heqjes së vizave dhe i dy shteteve të tjera me popullsi dominante muslimane dhe futja në listë e vendeve të cilat shkallën e korrupsionit e kanë shumë më të lartë se Shqipëria, tregon se BE nuk kërkon standarte, por kërkon ndryshimin e fesë muslimane nga shqiptarët dhe boshnjakët, duke shfaqur urrejtje për njerëzit që e mbartin këtë fe. Vendimi i BE e është një njollë turpi për këtë supershtet që nxit racizmin në mënyrë kaq ekstreme në emër të kulturës kristiane si kulturë e paqes dhe e civilizimit. Të nxitur nga vendimi i fundit i BE, intelektualë të ndryshëm dhe organizata joqeveritare kanë reaguar të indignuar për këtë gjest racist të ndërmarrë nga kultura gjithëpërfshirëse evropiane. Organizatat joqeveritare do të mblidhen në një tryezë të përbashkët, për të

reaguar ndaj këtij projekti të ri evropian për izolimin e muslimanëve të Ballkanit, duke përfshirë edhe shqiptarët me popullsi dominante muslimane. Po kështu, këto organizata do të reagojnë edhe kundër disa praktikave të ulta të disa organizatave antishqiptare të cilat kanë lobuar, për të mos liberalizuar vizat për shqiptarët. Eshte Lëvizja "Zgjohu" e cila i ka ftuar në një tryezë të rrumbullakët në hotel "Tirana" me datën 21 korrik, ora 11 të gjithë aktorët e shoqërisë civile për të diskutuar për këtë situatë absurde të izolimit të ri të popullsisë shqiptare muslimane në rajonin e Ballkanit, duke u kërkuar evropianëve të mos e kthejnë Ballkanin në një geto për muslimanët dhe shqiptarët. Edhe në territorin shqiptar vihet re lehtë një ndarje e padrejtë racizmi, sepse në pjesën jugore të vendit, pjesa e popullsisë se krishterë është e paisur me viza 5- vjeçare, kurse

pjesa më e madhe e popullsisë, që është muslimane, mbetet e persekutuar duke ndejur në rrallë të gjata për të marrë një vize, për t'u takuar me të afërmit e tyre që jetojnë jashtë vendit. Nga kjo lojë e re e racizmit evropian mbeten të diskredituar vetëm muslimanët dhe shqiptarët e Ballkanit. Regjimi i ri i vizave për Maqedoninë, Serbinë, dhe Malin e Zi do të sjellë probleme të reja për shqiptarët me popullsi muslimane dhe për muslimanët e Bosnjës, pasi izolimi i ri mbrenda Ballkanit do të jetë shpërblimi që Evropa u dha muslimanëve të Bosnjës, që u martirizuan dhe shqiptarëve për tolerancën e tyre fetare.

Materjali është marrë nga gazeta "Sot"

17 korrik 2009'

KA EVROPE RACISTE ANTIMUSLIMANE ME DIPLOMACI TE KORRUPTUAR

Pas vendimit të fundit të BE për përjashtimin e tre vendeve muslimane nga liberalizimi i vizave, ka patur reagime nga shoqëria civile e Shqipërisë, Bosnjës dhe Kosovës. Të gjitha këto organizata e shikojnë përjashtimin e këtyre shteteve me mazhorancë muslimane si një racizëm të pastër evropian. Shqiptarët vazhdojnë të mbeten pjesa e popullsisë evropiane më e përbuzur nga evropianët, ku nëpunës evropianë mund të marrin dieta të mira, rroga të mira, rryshfete nga politikanë të korruptuar. Evropiane mund të gjejnë edhe seks të zgjedhur nga senksere që duket se nuk mungojnë në Shqipëri. Racizmi i BE ndaj Shqipërisë kërkon të mbështesë islamofobët

e politikës evropiane të cilëve çdo shqiptar i duket një kopje e Bin Ladenit. Një pjesë e këtyre diplomatëve është kthyer në Shqipëri në një qeveri regjente që nxin realitetin e këtij vendi musliman që, sipas tyre, është i pazhvilluar. Fondet, që këto diplomatë marrin nga shtetet e tyre, i përdorin për të krijuar një grup servilësh që nxin realitetin shqiptar në interes të diplomatëve të korruptuar të BE. Model është ambasadori gjerman që nxin realitetin shqiptar duke qene figura më e korruptuar në historinë e diplomacisë së huaj në Shqipëri. Në këto kushte, kur islamofobia në Shqipëri po kap majat dhe politikanët evropianë nuk duan të njohin harmoninë fetare në Shqipëri dhe po këto diplomatë perendimorë shikojnë tek secili shqiptar një kami-



kaz me çallëm dhe me bomba në brez, integrimi i Shqipërisë në BE është i pamundur. Refuzimi për të përfshirë shqiptarët muslimanë në liberalizimin e vizave është një akt i turpshëm i diplomacisë së korruptuar evropiane ndaj një populli që kër-

kon të integrohet në familjen e madhe evropiane të cilës shqiptarët i përkasin.

Materjali është marrë nga gazeta "Sot" 24 korrik 2009

FYTYRA E VERTETE E EVROPES RACISTE

Në debatin i cili ka të bëjë me përjashtimin e tre vendeve muslimane të Ballkanit nga e drejta për të lëvizur të lirë pa viza nëpër kontinentin evropian, janë përfshirë tashmë figura të njohura politike të cilat, me deklaratat e tyre të pandërprera, po penalizojnë qëndrimin e paprecident qe BE mbajti ndaj tre vendeve muslimane të Ballkanit, duke e trajtuar kerkesën e popujve të këtyre vendeve nga pozitrat e një racizmi të egër antimusliman të cilin e kemi parë faktikisht edhe më të egër, kur është heshtur ndaj masakrave dhe vrasjes së muslimanëve në të katër anët e botës. Në një prononcim për këtë temë, ish- përfaqësuesi i lartë i BE për Evropën në Bosnje, Kristian Shellig, deklaroi se heqja e vizave për Serbinë është turpim më i madh që ka bërë BE deri tashti dhe se me këtë qëndrim BE po shpërblen vrasësit e Srebrenicës që bënë krimin më të rëndë në Evropë pas LDB. Dis-

kriminimi që po u bëhet popujve muslimanë të Ballkanit është një sinjal i qartë se Evropa është e mbushur me një fobi të theksuar kundër muslimanëve të Ballkanit dhe me këto qëndrime ata shkelin edhe parimet e tyre që mbështeten në liritë universale ku përfshihet edhe feja.

Sidomos, me këtë qëndrim BE shkel te drejtën e qarkullimit të lirë të njerëzve dhe mallrave drejt Evropës. Shqiptarët ka thujse dy dekada që thërrasin se jemi pjesë e Evropës dhe se e kemi vendin në Evropë. Por, e vërteta qenka ndryshe, sepse ne e duam Evropën, kurse ajo nuk na do. Atëherë si t'ia bëjmë hallin dhe nga të shkojmë tashti? Të rrijmë në "Geto", apo të kërkojmë rrugëdalje, duke i hedhur sytë nga Lindja, që pastaj kjo Evropë antimuslimane të kërcejë perpjete nga pasojat që do të ketë? Politika do ta hedhë pa tjetër në treg shumë shpejt se cila do të jetë rruga që do të pasojë për t'u dhënë shpresën muslimanëve të Ballkanit që e shohin

vehten të braktisur nga ata tek të cilët kishte aq besim. Është i saktë pohimi se lënia jashtë e tre vendeve muslimane është bërë vetëm për arsye fetare, sepse ne njohim poshtërimin që po i bën Evropa e krishterë Turqisë e cila ka dekada që kërkon të bëhet pjesë e BE, por lihet jashtë për standarte që duket se i plotëson një Mal i Zi që është kampion për kontrabandën e cigareve. Kur është fjala për t'u dhënë të drejtat muslimanëve, atëherë BE nxerr nga sirtarët stantartet e saj të njohura antiislame dhe i zbaton ata në kohë të reja, sepse duket qe Evropa vazhdon të notojë në konceptet raciste të kryqzatave të dikurshme, kur kryqtarët evropianë shkuan të masakrojnë muslimanët në hapësirat që ishin mijra kilometra larg Evropës. Po kërkohe standarte nga vendet muslimane në parametra që nuk mund t'i realizojnë perfekt as vendet më të zhvilluara, sepse edhe atje lulëzon krimi dhe korrupsioni. Të mos harrojmë se po i krijohen mundësi për liri levizeje Serbisë

që vrau mijra muslimanë në Kosovë dhe në Bosnje, Maqedonisë që shkel në mënyrë flagrante të drejtat e shqiptarëve. Po kështu Mali i Zi, nje shtet që sapo e ka fituar pavarësinë. Kurse për shqiptarët muslimanë dhe boshnjakët muslimanë vendosen bariera duke u hapur rrugë kriminelëve dhe duke vrarë për së dyti viktimat. Vendimi përjashtues që mori Evropa kundër muslimanëve në Ballkan ka edhe një të mirë, sepse masakat ranë dhe muslimanët po e shohin sa i do Evropa dhe sa e gabim e kanë ato kur tregohen te njëanshëm, duke deklaruar se jemi evropjanë dhe se historia na lidh vetëm me Evropën të cilën e duam shumë, por që nuk na do aspak. Duket se ish-kryemistri i Turqisë, Mehsumt Illmaz, kishte shumë të drejtë kur, i shqetësuar nga qëndrimi i BE për pranimin e Turqisë si anetare e saj, e quajti Evropën me të drejtë, "Një Klub i Krishterë"

Selim Gokaj

PROTESTE NE TIRANE PERBALLE DELEGACIONIT TE BE

Forumi Ballkanik për lëvizjen e lirë organizoi një protestë me 27 korrik në Tiranë përballë delegacionit të BE për të protestuar kundër qëndrimit racist dhe antimusliman të Drejtuesve të lartë të BE të cilët përjashtuan shtetet me popullsi dominante muslimane të Ballkanit nga e drejta për të lëvizur të lirë në hapësirat e BE duke treguar se Evropa vazhdon të ketë pikë referimi islamofobinë dhe metodën e përjashtimit të muslimanëve nga e drejta për të qënë pjesë e Evropës. Tashmë po bëhemi dëshmitarë etë tre getove të reja në Ballkan. Organizatorët e prptestës lëshuan 27 yollumbace që simbolizojnë shtetet e listës së

Shengenit. Në secilin tollumbace ishte një mesazh kundër racizmit dhe kundër Oli Ren që nuk pranoi të vizitojë vendet e përjashtuara nga lëvizja e lirë në Evropë. Në tollumbace ishin të vendosura postera me parulla të tilla si: "Stop racizmit", "Stop Islamofobisë", "Stop diskriminimit". Tollumbacet arritën të ngrihen lart deri tek dritaret e ambasadorit të BE në Shqipëri duke u parë këto tollumbace nga të gjithë anëtarët e delegacionit të BE. Ky ishte reagimi i parë që shoqëria shqiptare bëri ndaj qëndrimit racist që manifestoi BE duke përjashtuar nga lëvizja e lirë popullsinë muslimane të Bosnjes, Kosovës dhe Shqipërisë. Pa tjetër BE do të përballlet edhe me reagime të



tjera nga shoqatat muslimane, nga KMSH dhe bashkësi qytetare të cilat janë shumë të shqetësuara nga diferencimi, persekutimi, racizmi dhe islamofobia që po manifeston BE kundër vendeve

me popullsi dominante muslimane siç janë Shqipëria, Kosova dhe Bosnja.

Forumi Ballkanik për levizje të lire

NJE NUSE E ARGJENDE NE HYRJE TE QYTETIT TE SHKODRES



Kur nje vizitor ka vendosur te shoh qytetin e madh verior, Shkodren, sapo i afrohet hyrjes se saj, "do te pershendetet" dhe do te marre ne menyre te figurshme mireseardhjen e pare nga nje vepër kulti fetar musliman i cili eshte xhamia e Bahçalleku qe, me prezencen e saj ne kete pozicion dhe me paraqitjen e saj sa modeste, aq edhe madheshtore per misionin qe realizon, te qeteson shpirtin dhe te ngroh zemren, duke te bere qe ta shohesh vehten si ne shtepine tende, sepse mikepritja e nje xhamie ne hyrje te nje qyteti eshte nje gje qe vizitori mund ta takojte shume rralle. Ne Shkoder, numuri i xhamia eshte me dhjetra, ku spikasin xhamia madheshtore, Ebu Beker, e ndertuar nga vellezerit arabe El-Zamil dhe xhamia e Parruces, e ndertuar nga besimtari dhe bamiresi i nderuar shkodran, Seit Fishta. Por, edhe xhamia e Bahçallekut e ka historikun e saj, sepse nuk ka qene gjithmone me kete pamje qe ka sot. Besimtaret e Bah-

çallekut dhe ata qe e njohin historikun e xhamise se Bahçallekut permes shprehjes "se ka qene xhamia e pare kurse kjo eshte e dyta," te hapin horizontin per te njohur xhamine e Bahçallekut. Po kush ka qene ajo qe e ka marre emrin xhamia e Bahçallekut?

Faktet dhe deshmitaret flasin se ajo eshte ndertuar me kontributin financiar te vete banoreve te Bahçallekut dhe se eshte dalluar per nje minare te larte qe ka pase qellim te ndigjohej ezani sa me larg. Xhamia nuk ka qene vetem nje vend, ku besimtaret kane kryer ritet fetare islame, por ajo ka pase edhe mejtepin e vet i cili ka qene nje shkollë fetare, ku femijet merrnin dije per fene islame, duke u bere keshtu kontigjenti i xhematit te ardhshem. Edhe atehere besimtaret nuk mungonin ne Bahçallek, sepse ata qe shkonin ne xhami ishin te shumte. Termeti i vitit 1905 e demtoi ndertesen e xhamise, duke i rrezuar edhe minaren te cilen, per mungese fondesh, besimtaret nuk arriten qe ta ngrinin ne kembe. Xhamia ishte ne ata vite me nje trashegimni te

pasur te cilen besimtaret e nderuar te Bahçallekut ia paten lene asaj si dhurate. Behet fjale per 6 dyqane, nje shtepi, truall varrezash dhe 53 dynym toke, vlera keto qe sot te bejne te mendosh shume per kontributin e ketyre besimtareve per fene islame, i cili duhet te merret si shembull per xhematlinjte dhe besimtaret e tjere qejane larg safave te faljes te cilet, kur dhurojne per xhamine, marrin ne dore nje pikatore qe mos te kalojne kufirin minimal te dhurates qe kane vendosur te japin per xhami. Fati i xhamise se pare u rendua maksimalisht ne vitin 1967, kur u ndalua aktiviteti i saj fetar per t'u kthyer ne nje oficine socialiste, qe ateistet komuniste te flinin te qete pa ezanin qe ua prishte gjumin, i cili u zevendesua nga kumbona e kooperatives dhe zilja e ores qe i benin te vraponin per nje cope buke qe do te fitonin duke punuar per socializmin. Do te jete termeti i 15 prillit 1979, qe do ta rrafshoje krejtesisht ndertesen e xhamise e cila mbeti e tille deri sa u rihap feja ne vitet 90, kur xhamia e Bahçallekut do te fillonte te qehet tashme xhamia e dyte. Po kush eshte faktikisht xhamia e dyte te cilen e shohim madheshtore si nje nuse te argjente me ate minare elegante ne hyrje te Shkodres sone te dashur? Eshte ndertuar ne vitin 1997 nga kontributi i bamiresit nga bota arabe, te nderuarit Ahmed el-Kas-Sat, me ndermjetesine e vellezerve te nderuar, H. Vehbi Gavoçi dhe H. Nuh Gavoçi te cilet i shperblefte Allahu xh.sh. me xhenet per kontributin e tyre qe i dhuruan besimtareve te lagjes Bahçallek kete xhami qe eshte nje shtepi e Allahut per besimtaret muslimane. Xhamia e re ka nje salle faljeje 13x 13 dhe nje minaret betoni shume elegante. Vlera e dhurates dhe madheshtia e pamjes qe xhamia percjell do te ishin pa vlere, nese ajo nuk do te ishte sot funksionale, ku xhemati do te ishte vlera e arte e saj. E verteta eshte se sot xhamia e lagjes Bahçallek, me nje popullsi dominante muslimane, eshte pjese e rendesishme e aktivitetit fetar qe bejne besimtaret muslimane ne qytetin e Shkodres. Ajo ka xhematin e saj modest, por te konsiderueshem, qe eshte gjithmone ne rritje si numur, sepse ne xhamine e Bahçallekut behen rregullisht kurse fetare me femijet muslimane te cilet do te jene xhemati i ardhshem i kesaj xhamie dhe me gjere. Ne in-

teresimin e vazhdueshen te femijve per te vazhduar keto kurse, ka pjesen e vet edhe imami i xhamise, i nderuari Ademir Xama, i cili tashme per xhematin dhe femijet qe po behen pjese e ketij xhemati eshte bere imam, mik, vella musliman dhe nje shok i respektuar. Vitet e fundit xhamia po ndryshon pamjen e saj per mire. Ajo ka nje lulishte me tendence per t'u bere me e kompletuar dhe me e bukur. Perpara saj dhe rrotull saj po shtohet numuri i pemeve te mbjellura te cilat te bindin se jo shume larg ne kohe, ambjenti i jashtem i xhamise se Bahçallekut do te jete nje mundesi, ku besimtaret do te shohin se si, me perkujdesje dhe perkushtim fetar, mund te kalojne nje pasdite te paharruar ne mes te luleve dhe gjelberimit. Ne kete reportazh te shkurter mendojme qe te evidentojme kontributin financiar te xhematit per miremajtjen e xhamise per te gjitha problemet me te cilat ajo perballohet. Te dhurosh per xhami, do te thote te marresh shume sevape dhe dhuruesi me i mire eshte besimtari me i mire. Ne Bahçallek ka pase dhe ka besimtare te tille. Ka pase dhe ka kontribues te paharruar per fene islame dhe per mbarevajtjen e besimit fetar islam ne Bahçallek Nje nder ata ka qene rahmetliu, Zaim Zaganjori i cili per besimtaret muslimane te lagjes Bahçallek do te mbetet muezini shume vjecar i kesaj xhamie qe kontriboi me te gjitha mundesite qe xhamia te ishte nje ambjent ku muslimanet te kishin mundesi t'i faleshin Allahut xh.sh. Allahu xh.sh. e shperblefte me xhenet kete besimtar i cili ishte aq kontribues per fene islame ne lagjen Bahçallek. Mendojme se xhamia e Bahçallekut mbetet nje shembull dhe tregues per mire tek e cila shume xhami dhe imame kane shume nevojte te konsultohen me vleren e saj, ne menyre qe eksperienca dhe arritjet e saj te kalojne kufijte e lagjes Bahçallek, qe kontributi per fene islame te rrezatoje se pari nga xhamiat dhe xhemati i tyre, sepse vetem atehere muslimanet do te jene te fituar ne adhurimin qe i bejne Allahut xh.sh.

Selim Gokaj

Shkoder, me 15 korrik 2009

INFORMACIONE MEDIATIKE NGA "ZERI I TURQISE"

50 VJET KERKESE E TURQISE PER TE QENE PJESE E BE

Janë bërë 50 vjet që Turqia po kërkon që të bëhet pjesë e BE me të drejta të plota në një kohë që BE vazhdon ta refuzojë kërkesën e Turqisë duke ngritur si pretendim se shteti turk nuk po realizon standartet për t'u bërë pjesë e Be. Faktikisht shteti turk dhe qeveria e tij i janë përgjigjur kërkesave të BE në drejtim të realizimit të standarteve të kërkuara duke mbrojtur njëkohësisht edhe vlerat dhe detyrimet që qeveritë turke kanë patur dhe kanë ndaj interesave të popullit turk dhe vetë rolit dhe detyrës që ka Turqia në are-

nën ndërkombëtare. Por shtimi i rrallëvë të BE me shtete që nuk mund të krahasohen me Turqinë në asnjë tregues të bën të dyshosh në pretendimet e BE për mos realizimin e standarteve të kërkuara nga BE nga ana e Turqisë. E verteta tashmë është shumë e lexueshme, sepse kjo ka dalë qartë nga deklaratat e disa udhëheqësve të vendeve evropiane si: Austria dhe Franca të cilat e kanë kundërshtuar pranimin e Turqisë në rrallët e BE, duke u mbështetur edhe nga demonstrata të mëdha nga popujt e këtyre vendeve të cilat i motivojnë këto protesta me

obsionin e të qenunit të Turqisë një vend me popullsi muslimane. Duket se Evropa vazhdon ta shohë e trembur në ëndër përsëri Perëndorinë Osmane, duke e barazuar shtetin turk të shekullit 21 me Perëndorinë Osmane të shekujve më parë që zgjerohej në emër të një perëndorie sa më të madhe. Qëndimi i BE ndaj Turqisë tregon se parametrat që përdor BE janë me dy standarte të cilat tregojnë se BE është larg standarteve të vërteta demokratike të cilat duhet t'i ketë një organizatë e tillë që e quan vehten një qendër e demokracisë botërore, por që

rëalisht reflekton një islamofobi e cila e akuzon këtë organizëm politiko-ekonomik për ksenofobi dhe shkallë të ulët demokracie Duke qenë në një parametër kaq të shtrirë në kohë kërkësa e Turqisë për të hyrë në BE dhe e pa pranuar deri në këto momente, ne bindemi se BE ka për të bërë një rrugë të gjatë për të plotësuar vetë ata standarte që u kërkon të tjerëve sepse, me këtë qëndrim ndaj Turqisë, BE ka marrë pamjen e atyre klerikëve për të cilët thuhet se propogandonin slloganin "Ben si të them unë dhe mos bën si bëj unë"

KRYEMINISTRI ERDOGAN PERGEZON BERISHEN PER FITOREN

Kryeministri i Turqisë, Taip Rexhep Erdogan, i ka telefonuar kryeministrin shqiptar, Sali Berisha, duke e uruar për fitoren e tij në zgjedhjet parlamentare. Ai e cilësoi fitoren të merituar dhe me shumë rëndësi për vazhdimin e reformave. Erdogan e siguroi kryeministrin Berisha se Turqia dhe qeveria që ai drejton do ta mbështesin fuqishëm kryeministrin Berisha dhe qeverinë e re që ai do të kryesojë, duke theksuar se Turqia do të mbetet aleati

i rëndësishëm i Shqipërisë në të gjitha fushat, si ato politike dhe ato ekonomike. Në përgjigjen e tij, kryeministri Sali Berisha i shprehu mirënjohjen e thelle, mikut të tij, kryeministrin Erdogan, për mbështetjen e gjithanshme dhe të vazhdueshme që qeveria që ai kryeson dhe i gjithë kombi turk i ka dhënë kryeministrin Berisha dhe Shqipërisë. Berisha shprehu angazhimin e tij dhe të qeverisë që ai do të drejtojë se do të punojë për të forcuar dhe më shumë marrëdhënjet e shkëlqyera që janë sot në mes të Turqisë dhe të



Shqipërisë. Të mos harrojmë se Turqia është shteti i parë që e ka përgëzuar kryeministrin Berisha dhe koalicionin që ai

drejton së bashku me LSI për fitoren në zgjedhjet e qershorit që u zhvilluan në Shqipëri.

PATRIARKU I LARTE I RUSISE FALENDERON KRYEMINISTRIN ERDOGAN

Ne kuader të bashkëpunimit nderfetar të Turqisë dhe të Rusisë, ka bere një vizite ne Turqi Patriarku i larte i Kishes Ortodokse Ruse i cili, ne planin e vizitave qe ka bere ne Turqi, eshte takuar edhe me kryeministrin e Turqise, Taip Rexhep Erdogan, te cilit

i ka thene ,gjate bisedes qe ka zhvilluar, se ne te gjithe Rusine eshte pershendetur qendrimi i juaj ne Davos te Zvicres, kur ju keni mbajtur qendrim ndaj presidentit te Izraelit, Simom Peres, per shkak te vrasjes se civileve te pafajshem ne Gaza te Palestines. Partriarku i larte i Rusise, duke e rritur falenderimin per qendrimin e kryeministrin turk

ne Davos te Zvicres, iu drejtua atij plot respekt duke i thene se ju jeni duartrokatur ne te gjithe Rusine. Qendrimi i Patrikut te larte te Kishes Ortodokse Ruse ndaj krimeve te shtetit izraelit kunder palestinezëve ne Gaza tregon se krimet kunder civileve jane te denueshme dhe te penalizuara nga te gjithe institucionet fetare dhe jo fetare dhe jane

keto krime qe i bejne portretin e vertete te shtetit hebre qe u denua masivisht nga e gjithe bota e qyteteruar per genocidin qe beri dhe vazhdon te beje kunder popullit te pafajshem palestinez qe kerkon te jetoje i lire ne token e vet,

14 VJET PAS KRIMEVE KUNDER MUSLIMANEVE NE SREBRENICE

Tashme eshte bërë dite zie nderkombetare data 11 korrik 1995, kur ne nje hapësire te Bosnjes, te cilen e njeh e gjithë bota, u bë një krim kundër civilëve i përmasave te papara në Evropë pas LDB. Është Srebrenica ky qytet fatkeq që u godit nga armata jugosllave, paramilitarët serbë dhe mercenarë nga Rusia, Rumania, ku spikaste edhe një brigadë greke te qe e mbështetnin edhe vullnetarë nga Ukrahina të cilët mbrenda një harku kohor prej tre ditësh, vrane 10 mijë burra muslimanë qe ishin civilë të pambrojtur. Nuk duhet harruar se Srebrenica ishte shpallur zonë sigurie, detyrë që i ishte ngarkuar forcave hollandeze te OKB. Por, pas kuintave po luhej nje plan ogurzi kundër muslimanëve në Srebrenicë. Faktori ndërkombëtar, që planifikonte dhe skiconte hartën e Bosnjes së pas luftës, e kishte llogaritur Srebrenicën hapësirë të shtetit kukull serb të Bosnjes. Prandaj, me urdhër të këtyre qendrave antimuslimane evropjane, trupat hollandeze ua dorëzuan kriminelëve serbë Srebrenicën, duke u dhënë mundësi atyre të bëjnë një ndër krimet më të

mëdha që është bërë ndonjëherë kundër civilëve. Ushtarët hollandezë të OKB ua dorëzuan serbëve armët dhe uniformat e tyre dhe boshnjakët e mjerë u bënë pre e pushkatimeve massive nga kriminelet serbe. Telespektatorët që kanë parë një video amatore, e cila i kishte filmuar skenat e këtyre pushkatimeve massive, nuk mund të largojë nga kujtesa pamjet ku vrasësit bekoheshin nga priftërinj ortodoksë para se të ekzekutonin civilët muslimanë boshnjakë. Kasetat dhe filmime të shumta dëshmojnë për krimet në Srebrenicë. Varret të panumurta vazhdojnë të shtohen në Bosnje, sepse varrezat massive nuk kanë të mbaruar. Por, një gjë vazhdon të jetë në gjendje statukoje që nga 11 korriku i vitit 1995. Kjo është liria që gëzojnë ata që e bënë gjakun deri tek gjuni në Srebrenicë, ku më kryesori është gjenerali serb i ish-Armates Jugosllave, Ratko Mlladic i cili, sipas një pakti të pushpallur dhe sekret së bashku me Radovan Karaxhicin ishin siguruar se nuk do të gjykohej për krimet që kishin bërë, mjafton të ishin dakort me Paqen e Dejtonit. Sot, pas 10 viteve, në Hagë po gjykohet Karaxhiç, të cilin e



“shitën miqtë” për arsye politike. Kurse vrasësi tjetër, që ka përfituar nga marrveshtja me faktorin ndërkombëtar, Ratko Mlladiç shetit i lirë dhe me imunitet, pavarësisht se mbi të rëndojnë vrasjet më makabre pas Luftës së Dytë Botërore në Evropë. Cdo vit, me 11 korrik, ne Bosnje hapen varret të rinj për të varrosur kufoma të reja që janë identifikuar. Dhe ata nuk janë me dhjetra, por janë me qindra dhe me mijra, megjithëse në Gjykatën e Hagës Karaxhiç deklaroi se vetën disa qindra muslimanë janë vrarë në Srebrenicë. Në botë, sot varrat e luftës vazhdojnë të rriten

në numur dhe po kështu edhe viktimat vazhdojnë të rriten në numur, pa harruar se muslimanët vazhdojnë të mbeten viktimat e rrallës. Por, një gjë është shumë e sigurtë. Vrasjet dhe krimet kundër muslimanëve në Bosnje do të vazhdojnë të jenë për një kohë shumë të gjatë tregues i rrezikshëm i cili do të akuzojë ata që bënë vrasjet dhe sidomos do të jetë një akuzë me argumente kundër atyre qendrave antiislame që ëndërojnë që numuri i muslimanëve në botë t’i afrohet me çdo cmim numurit zeros.

Selim Gokaj

GJYKATE E HAGES DENON ME BURGIM VRASESIT E MUSLIMANEVE

Në gjykatën e Hagës kanë vazhduar gjykimet dhe dënimet për kriminelët serbë që kanë vrarë pa dallim civilët muslimanë në Bosnje gjate luftës fetare që u zhvillua në vitet 1992-1995 kundër elementit musliman që përbëntë 44% të popullsisë, fakt që ua prishte gjumin qendrave antimusli-

mane në Serbi dhe sidomos atyre jashtë Serbisë të cilat janë të panumurta nga Lindja në Perëndim. Në vendimin e saj të fundit, Gjykata e Hagës ka dënuar serbin Milan Lukic me burgim të përjetshëm, kurse kushëriri i tij, Predor Lukic është dënuar me 30 vjet burg. Këto kriminelë akuzohen se kanë djegur ne Vishegrad shtëpите muslimane pa u dhënë mundësi

banorëve të tyre që të dalin nga shtëpitë e tyre duke bërë që të shkrumbohen mbrenda shtëpive gra pleq dhe fëmijë. Megjithëse të akuzuarit i mohuan akuzat, gjykata me fakte i vertetoi krimet e këtyre monstrave duke u dhënë dënimin e merituar, dënim që nuk mund të lehtësojë dhimbjen e atyre që humbën njerëzit e tyre në mes të flakëve vetëm se ishin muslimanë dhe se

për këto kriminelë dhe ata që ishin pas tyre, aty afër ose edhe më larg, ishte normale që të digjeshin të gjallë

boshnjaket muslimane, ne nje kohe qe gjykata i quajti keto veprime te akuzuarve si krimet me te renda qe mund te behen kunder njerezimit.

Alban Kastrati

NJE ZONJE E MBULUAR NE SHTEPINE E BARDHE

Në përpjekjet e tij për të ndryshuar imazhin e botes islame për SHBA, pas atij qëndrimi të ashpër dhe veprimesh radikale kundër muslimanëve që zbatoi administrata e republikanëve me Bushin paragjykses për muslimanët, presidenti aktual, Barak Hysen Obama ka pranuar si këshilltare në Shtëpinë e Bardhë një zonjë muslimane te mbuluar me hixhab, e cila do të jetë përfaqësuese e muslimanëve në herarkinë më të lartë të shtetit gjigand që sot dominon botën. Presidenti

amerikan ,Obama, u bë objekt kritikash nga e djathta radikale amerikane për vizitat që ai bëri nëpër xhamia të ndryshme gjatë vizitës që zhvilloi ne Turqi. Tashti Presidenti Obama eci edhe më tej në rrugën e tij për të treguar se qëndrimi i Amerikës ndaj botës islame ka ndryshuar. Zonja e mbuluar muslimane, që do të punojë në administratën e lartë amerikane quhet Dalja Muxhahid, e cila do të japë informacione rreth feve dhe rolit që ata mund të luajnë ne problemet sociale të shoqërisë. Zonja Muxhahid është figurë e njohur në SHBA, sepse drejton qen-

drën studimore "Gallub" që bën studime në të gjithë botën për muslimanët. Kjo zonjë e nderuar do t'i percjellë administrates Obama mendimet e muslimanëve dhe çfarë presin ata nga amerikanët. Arsimimi i zonjës Muxhahid kap parametra të lartë, sepse është e diplomuar në degën e ekonomisë dhe të inxhinjerisë kimike. Ajo është autore e botimit " Kush flet në emër të islamit" Afrimi i një zonje të mbuluar në këtë pjesë të hierarkisë së lartë të administratës Obama tregon se mbulesa nuk është pengesë, por është dukuri e identitetit të një religjoni

të caktuar, i cili i lartëson edhe më shumë vetë vlerat e asaj shoqërie ku ai jeton dhe për të cilën edhe kontribon. Një emërim i permasave të tilla pa tjetër ka edhe sfond politik. Por, e rëndësishme është se presidenti i ri amerikan po krijon hapësira të reja për të gjithë qytetarët amerikanë, duke i dhënë dimensione më të avancuara vetë demokracisë amerikane të cilës administrata Bush i dha një të krisur të rrezikshme.

Përgaditi Bledar Dani

HETIM PER KRIMET KUNDER TALEBANEVE NE 2001

Presidenti amerikan, Barak Obama, ka kërkuar të fillojë hetimi për masakrën që është bërë kundër të burgosurve talebanë në vitin 2001 në Afganistan, pak para rënies së Kabulit në duar të koalicionit që kryesohej nga trupat amerikane. Së paku janë 1500 talebanë u ekzekutuan pa gjyq dhe në mënyrë më barbare nga njerëzit e Abdyl Rashid Dostum, një agjent i Cias, i njohur si Kryetar i Partisë Komuniste të Uzbekistanit që ka luf-

tuar vazhdimisht kundër muxhahidinëve. Presidenti Obama ka deklaruar se ka urdhëruar ekipin e sigurisë kombëtare për të mbledhur fakte për tragjedinë me të burgosurit talebanë në vitin 2001 në Afganistan. Obama ka deklaruar se hetimet nuk janë bërë në mënyrë të duhur. Prandaj, ai deklaroi se i kam kërkuar stafit tim që të mbledhë të dhëna që pastaj të marrim një vendim- theksoi ai në një intervistë të dhënë në Ganë ditët e fundit. Sipas gazetës më të madhe amerikane, "New York

Times," qeveria Bush e ka penguar gjithmonë nisjen e hetimit për këtë ceshtje.

Flitet se të burgosurit kanë dhënë shpirt në disa kontejnerë, kurse shumë të tjerë janë ekzekutuar me armë zjarri nga njerëzit e Dustumit- thekson në komentin e saj gazeta amerikane e lartpërmendur. Deklarata e presidentit Obama për këtë rast të rëndë tregon se në emër të luftës kundër terrorizmit, i është hapur drita jeshile bërjes se krimeve edhe më të rënda kundër muslimanëve, sepse edhe

talebanët muslimanë janë njerëz që duhen gjykuar dhe pastaj duhen dënuar, nëse janë fajtorë për atë që akuzohen. Nga ana tjetër, këto veprime të presidentit Obama tregojnë se Amerika e ka kuptur që urrejtja masive e botës islame kundër saj spjegohet me qëndrimin radikal dhe të padrejtë që Bushi dhe ata që e pasonin mbanin ndaj muslimanëve duke i peshuar të gjithë me peshoren e terrorizmit, në një kohe që muslimanët e luftojnë terrorizmin. (Informacion nga BBC)

SULME KUNDER HEBRENJEVE NE ANGLI

Stacioni radiofonik BBC, në lajmet e tij rutinë që jep çdo ditë në gjuhën shqipe, dha edhe një informacion jo shumë të papritur, sipas të cilit në Angli ka një tendencë në rritje të sulmeve që bëhen në këtë vend kundër hebrejve për motive të cilat BBC nuk i bën të njohura, por që një pjesë e tyre pa tjetër që kanë të bëjnë më pista politike, të cilat edhe këto janë pjesë e qëndri-

meve të qeverisë se hebrejve për probleme të rëndësishme ndërkombëtare, qëndrime këto që janë dënuar nga opinjoni publik botëror. Në këtë njoftim radiofonik është thënë se janë bërë mbrenda vitit 600 sulme te tilla me një tendencë në rritje për muajt e ardhshëm të këtij viti. Sot, në Angli jetojnë 300 mijë hebrej dhe është një veprim që të bën përshtypje përse kaq pak hebrej në Angli dhe këto të penalizohen. Mund të

jenë edhe pista të tjera që janë shkaktare të sulmeve mbi hebrejtë në Angli, por gjithmonë antisemitizmi ka qenë dhe është një dukuri e cila duhet dënuar, sepse penalizimet kolektive të popujve gjithmonë janë trajtuar si veprime të dënueshme, pavarësisht se segmente të fuqishme të një populli janë të angazhuara në veprime të dënueshme që kapin edhe parametrat e krimeve më të rënda pa përjashtuar edhe krimet kundër njerëzimit.

Urojmë që edhe hebrejtë të jetojnë dhe të veprojnë mrenda normave politike dhe ekonomike të një populli të qytetëruar dhe paqedashës, pa harruar ata fetare, në mënyrë që antisemitizmi dhe sulmet kundër tyre të mos jenë më dukuri e ditës në Angli, ose më vendet e tjera.

Informacion radiofonik i BBC

Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

SELAM-ALEJKUM! SOT DO TE VOTOJ PER EDI RAMEN

Kjo ishte pershendetja qe me dha nje besimtar musliman dhe praktikant i besimit islam ne mengjezin e ditës së 28 qershorit, kur shqiptarët po pergaditeshin te shkonin tek kutiat e votimit per te dhene voten e vet per subjektin politik te cilin desheronin ta shihnin ne pushtet duke e drejtuar shtetin shqiptar per katër vitet e ardhshme. Nuk e lashë te vazhdonte me gjate mikun tim, por i thashë se te japësh selam dhe te shkosh ne xhami dhe pastaj te vendosësh qe voten t'ia japësh Edi Ramës nuk është e pranueshme, sepse është po ky Edi Rama qe po e le Tiranën pa xhaminë e madhe, ne nje koha qe janë paratë per ta ndertuar dhe

është edhe truadhi i gatshëm ku mund te ndërtohet. Mos harro -i thashë mikut tim se është po ky Edi Rama qe ia ka dhene pergjigjen KMSH sipas se ciles se edhe profeti Muhamed po te zbriste ne tokë, muslimanët nuk do ta ndërtojnë kurrë xhaminë. Miku im i nderuar volli shumë helm padrejtësish ndaj Sali Berishës, i cili faktikisht ka shumë gjynahe ndaj muslimanëve shqiptarë, por politika dhe realpolitika percaktojnë qendrimet polilike te politikanëve si Sali Berisha i cili "i shtrirë ne arkivol" ka supervlera ne krahasime me Edi Ramën. Qëndrimi i mikut tim per fat te keq nuk është i veçuar, sepse jane te shumtë ne numur ata qe, nga formimi i pamjaftueshëm islam, e kanë te kufizuar edhe shkallën e

besimit islam . Nuk ka si spjegohet ndryshe votimi masiv i muslimanëve ne Tiranë per nje kryebashkiak si Edi Rama qe i le pa xhami duke i detyruar te falen neper sheshe dhe trotuare te mbuluara nga pluhuri dhe te permbytura nga shiu dhe debora. Si mund te spjegohet ky qendrim i muslimanëve ne Tiranë qe votojnë kunder interesa te muslimanëve ne favor te nje persekutori te vetë muslimanëve? Ka shumë mundësi qe punët e muslimanëve ne Shqipëri kështu do te shkojnë per shumë koha deri sa muslimanët te gjejnë nje gjuhë te përbashkët dhe te mos japin selam-alejkum, kur votën ia japin Edi Ramës, sepse është e ndaluar moralisht dhe fetarisht qe me nje dorë te përfaqosh mikun kurse me tjetren

te përfaqësosh qafirin , e thënë pak si populllore, nuk është normë fetare dhe morale qe muslimani te mbajë nje dorë ne hallvë dhe tjetren ta mbajë ne bakllavë, sepse kur muslimani qëndron ne nje pozicion te tillë ai nuk duhet te harrojë se gjynahet do ta rëndojnë aq shumë sa ai do ta shohin vehtën te kërrusur shumë nga numuri i papërbalueshëm i gjynaheve qe ai do te mbajë mbi supe te cilat kur te japin llogari para Allahut xh.sh. do ta bëjnë qe ta shohin vehten ne dyer e xhehnemit . aty ku te nxehtit e zjarrit te xhehnemit është i padurueshëm dhe i pafund.

Një kujtesë per ty nga nje vëlla musliman